



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 13.04.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura, më 16.03.2012 dhe 23.03.2012;
3. Shqyrtimi i situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011;
5. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentes lidhur me kthimin e Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për rishqyrtim;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura, më 16.03.2012 dhe 23.03.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së miratoi Procesverbalet e mbledhjes së mbajtur më 16.03.2012 dhe 23.03.2012, me vërejtjen teknike të bërë nga z. Fatmir Xhelili për procesverbalin e datës 16.03.2012.

3. Shqyrtimi i situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës

Kryetari i Komisionit- Pas ngjarjes që ka ndodhur në pjesën Veriore të Mitrovicës, duke u sulmuar qytetari dhe familja e z. Selver Haradinaj, akti terrorist që ka ndodhur por edhe veprimet kriminale dhe ilegale që ndodhin në komunat, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe në pjesën Veriore të Mitrovicës, për këtë qëllim kemi bërë rekomandime të përgatitura të cilat do ti paraqesë në këtë takim.

Duke qenë se mbikëqyrja që i bëjmë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës dhe Instrumenteve të Sigurisë në Kosovë, obligohen ti raportojnë Komisionit. Citoj dokumentin me rekomandime.

Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në mbledhjen e mbajtur me datë 13 prill 2012 pasi ka shqyrtuar situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës me theks te veçantë në komunat Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok dhe pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, ka marr vendim tu drejtohet me këto Rekomandime për ndërmarrjen e disa masave konkrete për sigurimin e rendit dhe sundimit të ligjit në këto komuna.

Situata e sigurisë në këto komuna, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës, vazhdimisht është duke u përkeqësuar, duke u shkelur Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës. Luftimi i shkeljeve kushtetuese dhe ligjore që janë duke ndodhur në atë pjesë të republikës së Kosovës, në vazhdimësi nga strukturat ilegale dhe kriminale të dirigjuara nga Serbia është përgjegjësi primare e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës që të kryejnë mandatin e vet për të vendosur sundimin e ligjit dhe të rendit.

Komisioni i rekomandon Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës që urgjentisht të planifikoj dhe të ndërmarr masa që të siguroj zbatimin e plotë të Kushtetutës në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Komisioni kërkon që 15 ditë pas

pranimi të këtyre rekomandimeve, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Drejtori i Përgjithshme i Policisë të raportojnë para Komisionit në një seancë të mbyllur për situatën në Komunat, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës.

Rekomandimet drejtuar Ministrisë të Punëve të Brendshme:

1. MPB-ja dhe Policia e Kosovës duhet të dëshmojnë përmbushjen e misionit për vendosjen e rendit dhe Kushtetutshmërisë. Pavarësisht situatës së ndeshme dhe specifikave që ka shteti i Kosovës, institucionet e saj duhet të marrin vendime dhe të çojnë përpara veprimet me interes për qytetarët e vendit. Duhet të bëhen vlerësime gjithëpërfshirëse të situatës së sigurisë dhe të veprohet konform me situatën e krijuar duke përdorur të gjitha mjetet kushtetuese dhe ligjore.
2. Të instalojnë dhe funksionalizojnë urgjentisht institucionet për mbrojtjen e rendit kushtetues, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.
3. Të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur qytetarët të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.
4. Të ketë një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë, në mes të mekanizmave që janë përgjegjës për sigurinë në Kosovë. Në disa raste ka rezultuar, që ky bashkëpunim dhe koordinim, nuk ka qenë në nivelin e duhur. Përveç me institucionet vendore, koordinimi dhe partneriteti duhet të fuqizohet edhe me praninë Ndërkombëtare në Kosovë si atë Ushtarake dhe Policore (KFOR dhe EULEX).
5. Organet e sigurisë pran pushteti lokal të Mitrovicës siç janë: Këshillat Lokal për Siguri Publike (KLSP), Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSb) dhe Këshillat komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb) duhet të kenë një mbështetje më të madhe, në kapërcimin e situatës së tensionuar dhe krijimin e një situatë më të qetë dhe stabile. Përpjekjet e lidershit për integrimin dhe krijimin e stabilitetit atje duhet të mbështeten më shumë nga Institucionet qendrore.
6. Policia e Kosovës në bashkëpunim me Qeverinë dhe organizmat tjerë përgjegjës, duhet të ndërmarrin hapa konkret që të sigurohet jeta, prona dhe lëvizja e lire në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës në mënyrë që të parandalohet vendosja e ligjit në duar të individëve.
7. Strategjia për neutralizimin e veprimtarisë së strukturave kriminale dhe strukturave ilegale të sigurisë duhet të jetë, një strategji e kombinuar, duke e bërë të çartë se nuk do të lejohet zhvillimi i aktiviteteve që cenojnë shtetin e Kosovës dhe sigurinë e qytetarëve të saj.

Këto janë rekomandimet, nëse keni sugjerime të tjera rreth përmbajtjes së dokumentit ai do të plotësohet me rekomandime shtesë.

Rexhep Selimi- Situata e Sigurisë në Republikën e Kosovës është pika kyçe e këtij takimi, si anëtar i Komisionit mbështes Rekomandimet dhe aktivizimin e Komisionit për

këtë çështje. Situatën në tri Komunitet veriore të Kosovës, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok dhe situatën në Pjesën Veriore të Mitrovicës e vlerësoj si një gjendje të tensionuar dhe të jashtëzakonshme dhe me probleme të mëdha dhe që krijon pasiguri për qytetarët shqiptarë që jetojnë në pjesën veriore.

Vlerësoj që Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka qenë në nivelin e përgjegjësisë që e përcakton Kushtetuta dhe nuk i ka kontribuar normalizimit të situatës. Situata në veri nuk është e izoluar as në kohë e as në hapësirë, por është një vazhdimësi e problemeve të shkaktuara nga Serbia dhe bandat që i kontrollojnë në Veri të vendit. Kjo situatë ka kulmuar me vrasjen e një qytetari shqiptar, Selver Haradinaj dhe sulmi me eksplozivë ndaj familjes së tij.

Ne duhet ta vlerësojmë ashtu siç është, si një sulm terrorist ndaj një popullate dhe kësaj situatë i kanë paraprirë edhe situata të tjera, tre rastet e fundit e bëjnë gjendjen shumë të tensionuar dhe shqetësuese për qytetarët dhe do të ishte e tillë edhe për organet e Sigurisë të Kosovës siç janë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, këtë situatë e bënë arrestimi i policëve të Kosovës në kufi, veprim i cili ka qenë një sulm ndaj integritetit territorial të Republikës së Kosovës, demolimit të pikës statike të vendosur në Veri të Mitrovicës në pjesën e tre rrokaqiejve, është bërë një sulm ndaj imazhit të Policisë, imazh të cilin nuk e ka Policia e Kosovës. Me këtë është tentuar që qytetarëve tu vishet një mos-besueshmëri tek Policia e Kosovës, gjë që nuk është e vërtetë pasi Policia ka kapacitetet për të menaxhuar situatën në veri.

Mbështes Rekomandimet e Komisionit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke e vlerësuar situatën të jashtëzakonshme, performancën e dobët të Ministrisë së Punëve të Brendshme në menaxhimin e situatës në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Goran Marinković- Shpreh ngushëllime për familjen e z. Selver Haradinaj. E vlerësoj si akt kriminal, dhe nuk jam i informuar që dikush është arrestuar për këtë akt. Mendoj që shteti Serb i ka gjykuar shpesh këto struktura që veprojnë në veri.

Problemi i Kosovës në pjesën veriore është grumbulluar ndër vite dhe është fshehur dhe kemi ardhur në situatën që të gjitha këto probleme pretendohet të zgjidhen përnjëherë. Mendoj që duhet të bëjmë përpjekje për uljen e tensioneve atje, integrimin e këtyre njerëzve në shoqëri dhe jo të mendojmë për dërgimin e policisë, Rekomandimet duhet të jenë qetësuese dhe jo politike dhe ndërhyrëse.

Jam kundër Rekomandimeve që janë propozuar nga Komisioni për t'iu dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kryetari i Komisionit- Këto Rekomandime i kam ofruar që ti diskutojmë në Komision në mënyrë që të kemi një draft të tyre. Pas harmonizimit të tekstit duke përfshirë sugjerimet e të gjithë anëtarëve mund ta bëjmë draftin final, i cili më pas do ti dërgohet Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në bazë të Kushtetutës, kërkojmë që të vendoset rendi dhe qetësia në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke mbrojtur jetën e qytetarëve, pronën e tyre dhe atë që quhet tërësi territoriale e Kosovës. Me që Komisioni mbikëqyrë Ministrinë e Punëve të

Brendshme dhe Ministrie dhe Ministrisë së FSK-së, u drejtohem kur e kemi të nevojshme. I jemi drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme që të mbroj të gjithë qytetarët pa dallime, pronën e tyre. Kjo kërkesë është kushtetuese për një vend që pretendon të jetë demokratik ku të sundoj rendi dhe ligji.

Fatmir Xhelili- Është e vërtetë që situata në veri të vendit nuk është e tashme dhe nuk gjeneron prej tani, kjo situatë ka një kohë të gjatë dhe është më e komplikuar në fushën e sigurisë, vendimmarrja dhe koordinimi i aktiviteteve të aktoreve që janë përgjegjës për sigurinë në pjesën veriore janë të komplikuara.

Rekomandimet e propozuara nga Komisioni janë në kuadër të ligjit dhe të kushtetutshmërisë dhe janë një përkrahje për institucionet e sigurisë, që të marrin hapat adekuat në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjeve bazike me të cilat këto institucione funksionojnë.

Nuk është qëllimi që menaxhimi i situatës në veri të jetë vetëm “policor” pasi në shprehje vijnë të gjitha aktivitetet politike, diplomatike por edhe policore. Rasti më i keq do të ishte sikur të “kuptohet” që Policia e Kosovës synon që me mënyrë policore të menaxhojë situatën në veri, gjë që nuk është e vërtetë. Një situatë e qetë u intereson edhe qytetarëve serb që jetojnë në veri të vendit, në mënyrë që të jetojnë pa shantazhe dhe pa kërcënime nga grupet joligjore.

Duke u bazuar në Raportin e ICO-së (Zyrës Civile Ndërkombëtare), 50% e qytetarëve të tri Komunave Zveqan, Leposaviq dhe Zubin Potok, janë të interesuar për punësim, infrastrukturë dhe mirëqenie sociale.

Një element tjetër negativ që pretendohet të “nënkuptohet” kinse Policia e Kosovës nuk është e përgatitur të ndërmarr veprime konkrete, taktike-operative në drejtim të veprimeve kundërligjore, krimi të organizuar etj. Policia e Kosovës është e përgatitur, me kompetenca dhe demokratike dhe që i përmbahet parimeve dhe procedurave duke u bazuar në ligj.

Do të ishte mirë që përgjegjësia të adresohet, qoftë tek menaxhuesit e Policisë apo menaxhuesit e politikave të përcaktimit të qëllimeve të Policisë, në mënyrë që të ketë adresë të qartë të përgjegjësisë. Sikur Policia të bënte planifikimet adekuate përball qëllimeve të politikës, atëherë Policia do të jetë në gjendje të bëjë planet operative të nevojshme, të arsyeshme, të mundshme dhe zbatuese për realizimin e operacioneve që kërkohen nga politika ditore.

Nuk do të ishte e rrugës që, Policia për një periudhë të shkurtër të vendos për operacione të papërgatitura mirë, pa qartësuar arsyet, qëllimet dhe rreziqet e operacionit por edhe të pjesëmarrësve të tjerë në operacion, duke dal kështu Policia e pasuksesshme në detyrat e përcaktuara. Është e pakuptimtë vendosja e një pike statike të “kartonit” dhe dy policëve, të cilët e kanë të vështirë menaxhimin e situatës.

Policia janë të autorizuar për përcaktimin e metodologjisë policore, por njihen metodologjitë dinamike të policisë në terrene të papërshtatshme për veprimin e tyre, prandaj mendoj që nuk është e nevojshme vendosja e pikave statike, por ndërmarrja e masave që patrullimet të jenë të plota dhe të koordinuara me EULEX-in, në mënyrë që rezultatet e operacioneve të jenë të suksesshme dhe arrestim i personave që e meritojnë një gjë të tillë.

Gjithashtu është e rëndësishme edhe koordinimi me KFOR-in, kjo ka qenë dhe kërkesë e Komisionit, pasi ka autorizime për ruajtjen e integritetit territorial të Kosovës. Aktivitetet e ndërmarrja nga dy segmentet e policisë, EULEX-i apo Policia e Kosovës, nuk do të jenë të suksesshme pa u mbështetur nga komponenti e KFOR-it. Kjo çështje kërkon maturi, përgjegjësi dhe vazhdimësi, gjithashtu edhe shteti duhet të ketë vazhdimësi të aktiviteteve dhe veprimeve të segmenteve policore ndaj atyre që veprojnë në kundërshtim me ligjin.

Identifikimi i qartë i personave, grupeve kriminale në pjesën veriore, bashkë me vlerësimin e rreziqeve nga të cilat vijnë, analiza parashikuese dhe përcaktimi i metodologjisë për arrestimin e personave, të rezultojë i suksesshëm, pasi një gjë të tillë e dëshirojnë qytetarët serb dhe shqiptar që jetojnë në atë pjesë. Në këtë drejtim, si Komision kemi dhënë rekomandime të cilat janë në përputhje me obligimet kushtetuese.

Rasim Demiri- Shpreh ngushëllimet e mija për familjen e z. Selver Haradinaj. Rasti që ka ndodhur është një sprovë e madhe, gjithashtu edhe komuniteti boshnjak që jeton në atë pjesë, në lagjen e boshnjakëve është i rrezikuar.

Ajo çfarë ka ndodhur në Mitrovicë ka shkaktuar probleme mes qytetarëve, është shteti ai që duhet të merret me zgjidhjen e këtyre problemeve e jo qytetarët vet.

Lëvizja Vetëvendosje në protestën e organizuar gjatë seancës plenare në Kuvend, do të duhej që në parullën ku ishin të vendosur tre emra të shqiptarëve që kanë humbur jetën në veri të vendit, të përfshinin edhe emrin e Shefka Sllavkovic e cila ka humbur jetën në vendin e punës në mbrojtje të Kushtetutës.

Kryetari i Komisionit- Rekomandimet të cilat janë përgatitur vlejné për tërë territorin e Republikës së Kosovës madje kemi theksuar edhe cenimin kombëtar fetar, racor pa dallime, në mënyrë që çdo qytetar i Kosovës të jetë në mbrojtje nga institucionet e Kosovës, pasi është obligim ligjor dhe kushtetues që të dalim në mbrojtje të gjithë qytetarëve.

Rexhep Selimi- Keni të drejtë z. Rasim Demiri, kur ngrini shqetësimin për të gjithë të vrarët në pjesën veriore, si para luftës por edhe pas luftës. Numri i viktimave vazhdon të shfaqet edhe pas luftës në pjesën veriore të vendit, vetëm gjatë vitit 2000 janë vrarë njëmbëdhjetë shqiptar pran urës dhe në pjesën veriore të Mitrovicës, para dhe pas kësaj periudhe dhe numri i tyre është i madh, gjithashtu është i madh numri i atyre që pësojnë nga bandat e dirigjuara nga shteti i Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, nga kjo pësojnë edhe komuniteti boshnjak dhe për këtë arsye ju inkurajoj që të reagoni në Parlamentin e Kosovës.

Emrat e ekspozuar në Parlamentin e Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje, nuk janë të vetmit të vrarë fatkeqësisht, por janë emra simbolik dhe për familjet e tyre të cilat janë të kërcënuara në të ardhmen.

Fatmir Xhelili- Shpreh keqardhjen për rastin Sllavkovic dhe Haradinaj por, duhet të qartësojmë gjërat pasi kemi të bëjmë me vepra terroriste të cilat janë aktivitete të izoluar. Shtyllat e përcaktuar për analizë të krimeve dhe Shtylla Inteligjente e Policisë bashkë me Agjencionin Inteligjent të Policisë, të nxjerrin vlerësime nëse është kjo ndonjë metodologji e Serbisë për të dëmtuar Kosovën në fazën që po kalon si shtet, apo me këtë realizojnë qëllime të grupeve kriminale për interesa materiale.

Serioziteti i hetimit që ka marrë për bazë Policia e Kosovës duke e trajtuar këtë rast si akt terrorist bashkë me hetimin që e zhvillon për rastin Sllavkovič, janë dy hetime që kanë seriozitet në qasje dhe kur të vjen momenti do të zbulohen aktorët e këtyre veprave dhe do të marrin ndëshkimin meritë. Sipas informacioneve në shtypin e ditës pothuajse janë zbuluar aktorët e vendosjes së eksplozivit në rastin e Selver Haradinajt dhe se Policia do të merr masat adekuate për ndëshkimin e tyre.

Goran Marinković- Pavarësisht retorikës kombëtare, shpreh keqardhjen për vrasjen e njëmbëdhjetë shqiptarëve në veri të Mitrovicës.

Retorika e bandave serbe nuk është e drejtë, pasi me këtë e akuzon një popull të tërë dhe kjo është e pa pranueshme.

Anton Quni- E kemi të qartë situatën që mbizotëron në disa pjesë të Kosovës, ka të bëjë me kufizimin e lëvizjes së lirë, për disa kategori të institucioneve dhe të qytetarëve, po ashtu në disa hapësira të Kosovës kemi krim të instaluar në shumë forma. Para disa kohe ka ndodhur një lloj agresioni me ndërhyrja e forcave policore dhe ushtarake në brendi të Kosovës, së fundi kemi një akt terrorist, fatkeqësisht këto ndodhin në një hapësirë ku dominojnë numerikisht komuniteti serb.

Këto dukuri gjenerohen nga strukturat kriminale, paramilitare, sekrete, ilegale të cilat burimin e kanë në qendrën e vet, brenda Kosovës në pjesën veriore por edhe jashtë Kosovës, dhe kryesisht lidhen me politika të gjeneruara nga Beogradi. Ne bëjmë përpjekje që këto probleme ti adresojmë dhe kërkojmë nga institucionet të cilat janë të ngritura për këtë qëllim, që ti luftojnë këto dukuri, që të krijojnë një ambient të sigurt dhe të garantojnë sundimin e rendit dhe të ligjit.

Për këtë çështje shteti i Kosovës i ka organet, agjencitë, por si Komision iu jemi drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komisionet e tjera do ti drejtohen Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, problemi do të adresohet edhe në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, pasi natyra e problemit është komplekse, dhe ne si Komision merremi me detyrat në kuadër të kompetencave që kemi.

Nga rekomandimet e propozuara, nuk shohë tendencë për hedhjen e fajit ndonjë komuniteti të veçantë apo krijimin e ndonjë klime që do të qonte në krijimin e ndonjë konflikti ndëretnik. Qasja jonë në mënyrë që veprimet e institucioneve të Kosovës të jenë

të mirë koordinuara me të gjithë faktorët ndërkombëtar që e kanë përsipër çështjen sigurisë, KFOR-i dhe EULEX-i, prandaj si anëtar i Komisionit i mbështes rekomandimet e paraqitura nga Komisioni.

Kryetari i Komisionit- Propozoj që mos të hyhet në tema që janë jashtë rekomandimeve të propozuara, të cilat i janë drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës për kryerjen obligimeve ndaj qytetarëve të Kosovës pa dallime. Ndërsa sa i përket ndërhyrjes dhe veprimit të shtetit Serb është e dukshme që ai ndërhyr, vizitat e zyrtarëve serb pa lejen e autoriteteve të Kosovës. Qytetarët e Kosovës janë të gjithë të barabartë pa dallim etnie, dhe vlerësimi se ka tendenca të tilla është e pa pranueshme.

Rexhep Selimi- E ri konfirmoj qëndrimin tim që, shteti i Serbisë qëndron prapa bandave në veri me atë çfarë Serbia manifeston në raport me Kosovën. Dihet që Serbia në Kushtetutën e saj e konsideron Kosovën pjesë territoriale të saj dhe kjo është ndërhyrja bazike që i bën shtetit të Kosovës.

Aktivitetet politike të Serbisë në komunat veriore Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, e bëjnë përgjegjëse për gjithë atë çfarë ndodh në këtë pjesë dhe i qëndrojnë mendimit që shteti Serb qëndron mbrapa këtyre veprimeve, gjithashtu zgjedhjet elektorale të organizuara nga Serbia në ato pjesë ku ka popullatë serbe, me fokus pjesa veriore e Mitrovicës është ndërhyrje në shtetin e Kosovës. Të gjitha këto aktivitete Serbia i mbushte mbi grupe kriminale të cilat kanë përkatësi serbe.

Kur i referohem banda serbe, nuk i referohem komunitetit serb, përkundrazi këtë komunitet e bëj përgjegjës që nuk reagon ndaj këtyre bandave mbi të cilat Serbia e ka të vendosur aktivitetin e saj armiqësor ndaj Kosovës. Nëse heq dorë nga termi banda, duhet të referohem me termin grupe terroriste të cilët terrorizojnë qytetarët në një pjesë të Republikës së Kosovës.

Goran Marinković- Se shteti Serb ndërhyr në Kosovë mendoj që nuk është kështu, në pikën e tretë të rendit të ditës duhet të jemi real. Kur është në pyetje veriu i Kosovës nuk reagojmë adekuat.

Në Graçanicë ka ndodhur që një autobus me qytetarë serb të cilët janë rrahur, vandalizuar janë liruar brenda ditës, për këtë arsye i tërheq vërejtjen Policisë dhe Gjyqësorit të cilët kanë bërë lirimin e këtyre personave në mungesë të provave. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në qytetin e Pejës dhe nuk është reaguar për qytetarin malazez dhe boshnjak. Reagimi duhet të jetë i njëjtë dhe jo i njëanshëm nga ana e Komisionit.

Vjollca Krasniqi- Ngjarjet e vazhdueshme që kanë ndodhur në pjesën e dytë të vitit 2011 me vrasjen e policit Enver Zymberi, pastaj agresioni ndaj shtetit të Kosovës me kidnapimin e dy zyrtarëve policor dhe tani vrasja e një qytetari dhe lëndimi i anëtarëve të familjes së tij në pjesën veriore të vendit, bënë të kuptosh që situata në veri të Kosovës është e tensionuar e pa sigurt dhe e brishtë.

Pas trembëdhjetë vitesh të çlirimit dhe katër viteve të pavarësisë, vdekja e qytetarëve të Kosovës nga dora e strukturave të organizuara serbe është e pa pranueshme, shqetësuese

dhe e dhimbshme. Kjo vrasje përveç të tjerash ka motive të spastrimit të pjesës veriore nga qytetarët shqiptar. Kjo gjë u pa nga pamjet televizive e cila ndjell frike, pasiguri tek qytetarët.

Thirrja për tu vetëmbrojtur nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës, e cila u kritikua, mendoj që në pamundësi për të bërë më shume, neglizhencën e Qeverisë bëri këtë thirrje "dy duar për një kokë". Përveç shqetësimit nga veprimet e shtetit Serb, shqetësohem edhe nga shteti i Kosovës, që nuk ndërmerr masa për të shtuar sigurinë në pjesën veriore.

Për këto vrasje duhet të ishte dikush përgjegjës, prandaj rekomandimet e propozuara nga Komisioni për institucionet relevante, do të doja që të merren në mënyrë serioze dhe të realizohen për vënien e rendit dhe qetësisë në tërë territorin e vendit.

Emin Gërbeshi- I përkrah rekomandimet e paraqitura nga Komisioni gjithashtu shpreh shqetësimin tim për Komisionin i cili pas ngjarjeve që kanë ndodhur në pjesën veriore të Mitrovicës, është dashur të mblidhet urgjentisht, të nxirrte disa rekomandime dhe të dilte me një deklaratë për situatën aktuale në Kosovë.

Sjellja e institucioneve të Kosovës në raport me situatën në veri të vendit nuk ka qenë në nivelin e duhur, as nga Parlamenti, Ministria e Punëve të Brendshme, Qeverisë duke përfshirë dhe Komisionin të cilit i përkas.

Në rastet e atakimit të qytetarëve shteti duhet të reagoj, kjo gjë nuk ndodh në Kosovë, duke dal me deklarata sikur të mos ishim shtet, të tilla si të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, ndërsa ne jemi shtet i pavarur, kemi institucionet e sigurisë të cilat duhej të reagonin për të rregulluar situatën e sigurisë për të gjithë qytetarët. Veprimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme për vendosjen e një pikë statike vetëm sa për të thënë, e kanë degraduar institucionin e Policisë së Kosovës.

Çështja e bandave kriminale e përmendur nga disa anëtar të Komisionit, mendoj që banda të tilla ka edhe nga radhët e serbëve dhe të shqiptarëve, banda të popujve të tjerë, të cilët veprojnë për qëllime të caktuara dhe fatkeqësisht në Kosovë ndodh një bashkëpunim mes këtyre grupeve.

Qeveria e Kosovës duhet të veproj shumë shpejt për identifikimin e bandave dhe veprimeve kriminale në pjesën veriore dhe jugore të Mitrovicës dhe të vendos rendin dhe ligjin për të mbrojtur të gjithë qytetarët. Mendoj që si Komision duhet të jemi më të angazhuar për çështjet e tilla të rëndësishme dhe të dalim me kohë me rekomandime.

Kryetari i Komisionit- Pajtohem që Komisioni duhet të jetë në nivelin e duhur, ne gjithmonë presim informacion nga institucionet të cilat i mbikëqyrin pastaj e bëjmë vlerësimin si Komision Parlamentar. Reagimin të cilin e bëjmë është i përbashkët dhe në emër të Komisionit.

Nëse nuk keni sugjerime të tjera për Rekomandimet e propozuara, këto i drejtohen Ministrit të Punëve të Brendshme. Afati është i caktuar prej 15 ditësh, ndërsa çështjet e detajuara mund ti paraqiten kur të jemi në takim me Ministrin dhe Drejtorin e Policisë.

Në fund të kësaj pike të rendit të ditës Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me tetë(8) vota “për” dhe një(1) “kundër” Goran Marinković, morri këtë:

VENDIM

Rekomandimet e propozuara në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së i dërgohen Ministrit të Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi. Komisioni kërkon që 15 ditë pas pranimit të këtyre rekomandimeve, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Drejtori i Përgjithshme i Policisë të raportojnë para Komisionit në një seancë të mbyllur për situatën në Komunat, Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës.

4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011

Kryetari i Komisionit- Raportin e posedojmë të gjithë anëtarët e Komisionit, e hap diskutimin rreth kësaj çështje.

Fatmir Xhelili- Propozoj që këtë pikë të rendit të ditës ta lejmë për takimin e radhës së Komisionit me qëllim që ti bëhet një studim më i hollësishëm këtij Raporti.

Kryetari i Komisionit- Nëse pajtoheni të gjithë, edhe unë jam i pajtimit që të lihet për takimin e radhës dhe propozoj që për të qenë me efektiv të krijojmë një grup pune në kuadër të Komisionit i cili bën një analizë të Raportit duke e sjell në Komision në mënyrë që të kemi një analizë të detajuar dhe të jemi më efektiv në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Në fund të kësaj pike të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Raportit të punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011, me këtë përbërje:
z. Fatmir Xhelili, kryesues dhe anëtarë z. Anton Quni dhe znj. Vjollca Krasniqi.

5. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentes lidhur me kthimin e Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për rishqyrtim.

Kryetari i Komisionit- Vendimin e Presidentes për kthimin e Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së të aprovuar më herët e kemi të gjithë. Citoj pjesën të cilës i referohet Presidentja, ku kërkohet ti shtohet një paragraf i ri Projektligjit "Nen 27 ti shtohet një paragraf i ri i cili lexon, *në rast të mungesës së fondeve publike Qeveria mund të bëjë shkurtime sa i përket përfitimeve nga ligji për të mos rrezikuar sigurinë financiare të Kosovës*"

Mendoj që ky paragraf nuk është i nevojshëm ti shtohet Projektligjit, për arsye se Forca e Sigurisë së Kosovës me kapacitetet që ka dhe pjesëtarët që dalin në pension, nuk rrezikojnë buxhetin e Kosovës dhe as të fondeve të cilat janë të përcaktuara për pensionimin e pjesëtarëve të FSK-së dhe se kredibiliteti i FSK-së në nivel të Kosovës është një çështje e ndjeshme, prandaj konsideroj që nuk ka nevojë që në ligj ti lihet Qeverisë që të ndërhyj, pasi ligji duhet zbatuar pavarësisht Qeverisë që do të udhëheq.

Fatmir Xhelili- Propozoj që grupi punues që ka qenë i përcaktuar për shqyrtimin e këtij ligji të mbaj takim si dhe të ftohet Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, bashkë me nënkryetarët e Komisionit, për tu konsultuar për reagimin dhe rekomandimin e këtij Komisioni për nenin 27. Ky nen rrjedh nga detyrimeve të pakos së ligjeve për relacionet krijuara me Fondin Monetar Ndërkombëtar, në mënyrë që pas këtij takimi të marrin qëndrimin si Komision.

Komisioni unanimisht ka propozuar nenin 27, por Ligji është kthyer nga Presidentja për përmbajtjen e tij, prandaj mendoj që duhet të kemi një takim të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Rexhep Selimi- Presidenti/ja, duhet të dijë se kur kthehet një ligj, pasi në bazë të kompetencave që parashihen në Kushtetutë ligji kthehet kur ai e rrezikon sigurinë e vendit, kur është kundër kushtetues. Mendoj që ligji për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së nuk e rrezikon sigurinë e vendit, dhe nuk është kundër kushtetutës, prandaj nuk heq dorë nga qëndrimi im për këtë çështje që nga hera e parë për këtë ligj.

Këto pensione nuk e rrezikojnë buxhetin e Kosovës, pasi numri i tyre është i vogël dhe buxheti nuk do duhej të ndihej i rrezikuar nga pensionet e ushtarakëve, prandaj mendoj që kthimi i ligjit nga Presidentja nuk e ndryshon mendimin tim për këtë ligj dhe për këtë nen të caktuar. Komisioni ka dhënë qëndrimin e vet herën e parë, nëse heq dorë nga ky qëndrim secili duhet të deklaroj veçmas.

Ganimete Musliu- Pajtohem me z. Fatmir Xhelili që të ftohet Komisioni për Buxhet dhe Financa për shqyrtimin e nenit 27, në mënyrë që edhe nëse mbesim me qëndrimet të cilat i kemi tani, të mos paragjykojmë vendimin e Presidentes për këtë ligj. Të merret mendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe pastaj si gjithmonë të dalim me një vendim unik si Komision për këtë çështje.

Goran Marinković- Mbështes mendimin e z. Fatmir Xhelili dhe znj. Ganimete Musliu, që të ftohet Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe pas shqyrtimit në këtë takim të plotësojmë vakumet në nenin 27 me amendamentin e propozuar nga Presidentja.

Anton Quni- Si Komision dhe si grup punues i kemi shprehur qëndrimet tona, duke marrur parasysh situatën për pensionimin e pjesëtarëve të FSK-së, por gjithashtu duhet ta kemi në konsideratë vendimin e Presidentes dhe pastaj në konsultim me të gjithë aktorët në lidhje me këtë ligj, ti marrim mendimet dhe nëse ka arsyeshmëri prapë si Komision të dalim me qëndrim.

Emin Gërbeshi- Mbështes mendimin që Komisioni për Buxhet dhe Financa të ftohet në takim për këtë çështje, ndërsa kundërshtoj vendimin e Presidentes për ligjin për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, i cili shprehet që ky ligj rrezikon sigurinë financiare të Kosovës.

Asnjëherë nuk kemi marrë letër nga Presidentja apo FMN-ja për shpenzimet e mëdha për blerjen e makinave luksoze që e rrezikojnë sigurinë financiare, prandaj mendoj që ky vendim është politik. Pjesëtarët e FSK-së meritojnë pensioni dhe se pas dëgjimit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa do të votoj pro këtij ligji, të formës fillestare të tij pa propozimin e Presidentes.

Rexhep Selimi- Përkrah takimin e përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe se qëndrimi im ndaj vendimit të Presidentes nuk i përjashton konsultimet e nevojshme, por pa e ndryshuar qëndrimin tim fillestar, pasi pensionet e pjesëtarëve të FSK-së nuk do duhej të cenoheshin nga vullneti i një Qeverie të caktuar.

Kryetari i Komisionit- Nga kjo që u tha është një pajtim që të kemi një takim me Kryetaren Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe nga arsyetimet e saj mund të shohim dhe reagimin në mbledhjen e radhës.

Në fund të kësaj pike të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Komisioni Për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së vendos orientimisht që në mbledhjen radhës së Komisionin në koordinim me agjendën e Komisionit për Buxhet dhe Financa të ftohet Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, znj. Safete Hadergjona në takim, për të shqyrtuar reagimin e këtij Komisioni për projektligjin për pjesëtarët e FSK-së.

Goran Marinković- Kërkoj që të ketë një koordinim të kohës kur të caktohen mbledhjet e Komisionit në mënyrë që mos të jenë të njëjta me mbledhjet e Komisionit që unë drejtoj.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Kemi një kërkesë nga Federata e Gjahtarëve të Kosovës të cilët kanë vërejtje rreth *ligjit për armë*, për këtë gjë i janë drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së. Propozoj që për këtë çështje të formohet një grup punues për shqyrtimin e kërkesës në mënyrë që Komisioni të ketë një pasqyrë më të qartë. Në mbledhjen e radhës së Komisionit do ta ngrinim përsëri këtë çështje për të vendosur mbi grupin punues.

Anton Quni- Nga vizitat që kemi pasur jashtë vendit, për ngritjen e një institucioni i cili do të merret me të drejtat e ushtarakëve, praktikë e cila përdoret në perëndim.

Kemi marrë disa përvoja dhe si Komision është mirë të iniciojmë punën, së pari të vlerësojmë rëndësinë e këtij institucioni, a është i nevojshëm për ne, duke supozuar që në 2013-ën ne do të kemi ushtrinë dhe paralelisht me këtë të ngritet edhe ky institucion që mbron të drejtat e tyre. Nëse jemi të pajtimit se duhet ta kemi këtë mekanizëm, duhet ti hulumtojmë mënyrat për hartimin e kornizës ligjore, duke e sjell në Parlament për tu bërë i zbatueshëm.

Kryetari i Komisionit- Anëtarët e Komisionit të cilët kanë marrë pjesë në vizitën në Gjermani, kanë parë nivelin e organizimit dhe nevojën e të drejtave të ushtarakëve. Ky institucion luan rolin e Ombudspersonit në kuadër të forcave të armatosura. Jam dakord që të analizohet kjo çështje, pasi ky institucion i duhet Kosovës për dy arsye, e para që të drejtat e ushtarakëve të realizohen duke qenë se do të kemi një ushtri të re dhe së dyti në raportet ndërkombëtare, korrigjimi nga brenda nga faktori vendor në mënyrë që raportet të jenë pozitive në funksionimin e FSK-së sot, por edhe të ushtrisë në të ardhmen e cila aspirojnë të jetë pjesë e NATO-s.

Fatmir Xhelili- Pajtohem me propozimin e z. Anton Quni, gjithashtu propozoj formimin e një grupi punues për të shikuar mundësitë, pasi segmentet e sigurisë në Kosovë nuk kanë një numër të madh të zyrtarëve dhe të shohim nëse do të jetë e mundur përdorimi i këtij mekanizmi për segmente të tjera, siç janë segmenti i Policisë, i emergjencës, të cilat janë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në të ardhmen në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes.

Realizimi i takimeve të punës me zyrtarë të segmenteve të sigurisë, duke e përmbyllur me dëgjim publik ku do të përfshihen edhe organizatat jo qeveritare si dhe të gjithë ata që mund të kontribuojnë në propozimet për përcaktimin ose jo për këtë instrument, i cili në shumë vende ka dhënë rezultate pozitive. Përshpejtimi i punës do të ishte me krijimin e një grupi punues, dhe propozimet të jenë se, a do të përdoret ky mekanizëm vetëm për ushtri apo edhe për Policinë dhe Agjencionet e emergjencave.

Rexhep Selimi- Në njërin nga takimet e radhës kjo çështje të futet në kuadër të aktiviteteve të Komisionit, në mënyrë që kjo çështje të jetë si pikë e rendit të ditës në njërin nga mbledhjet e radhës së Komisionit dhe në këtë takim të formohet grupi punues, i cili do të hulumtoj për krijimin e këtij institucioni, si dhe rrethanat ligjore që e mundësojnë këtë gjë. Mbështes propozimin e z. Fatmir Xhelili që ky mekanizëm të

shërbente edhe për komponentin e Policisë, gjithashtu duke shfrytëzuar përvojat nga vizita në Gjermani të kontribuojmë në krijimin e këtij mekanizmi.

Fatmir Xhelili- Kur iu referova Agjencionit për reagim emergjent, mendova për njësitë e zjarrfikësve, pasi kjo njësi ka mbetur nën hije. Në vonesë të implementimit të ligjeve adekuate qoftë nga pushteti lokal, qoftë ligjeve për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore, të përfshihet edhe ky komponent në kuadër të mekanizmit për mbrojtjen e të drejtave të forcave të armatosura. Për këtë besoj do të kem edhe përkrahjen e anëtarëve të Komisionit.

Kryetari i Komisionit- Mbetët që në një mbledhje të ardhshme kjo çështje të jetë pikë e rendit të ditës dhe konsideroj që e përfunduam takimin me këto pika të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi